



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2023

VENDIM

Nr.95, datë 06.03.2023

**PËR
TRANSFERIMIN E PËRKOHSHËM ME PËLQIM
NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
TË GJYQTARIT Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61 dhe në shkronjën “c”, të nenit 86, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 1, të nenit 46, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 9, të Vendimit të tij nr. 23, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar, vendimet nr. 25 – 30, datë 18.01.2023, pasi shqyrtoi kërkesat e gjyqtarëve që kanë dhënë pëlqimin për transferim të përkohshëm, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në një pozicion të përkohshëm në fushën e së të drejtës civile të gjyqtarit z. {...}, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.
2. Efektet juridike të transferimit të përkohshëm fillojnë më datë 13.03.2023.
3. Gjyqtari {...} përjashtohet menjëherë nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër.
4. Gjyqtari {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet civile që kanë kaluar në seancë gjyqësore dhe çështjet penale të cilat janë në fazën e konkluzioneve përfundimtare si në seancë paraprake, ashtu edhe seancë gjyqësore, si dhe ato në çdo

gjykatë tjetër i caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Çështjet e tjera gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër dorëzohen menjëherë prej tij.

5. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit të transferuar përkohësisht z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR